



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.788/6 prot.

Tiranë, më 14.06.2023

VENDIM

Nr. 28, datë 14.6.2023

PËR KONTROLLUESIN “GRUPO DE LEMUR” SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “*Grupo de Lemur*” SHPK (në vijim, “*Kontrolluesi*”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 62, datë 26.04.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një shoqëri tregtare, me NIPT M02223014P, që ka si objekt të aktivitetit të tij, tregti me pakicë të produkteve shtëpiake, si dyshek, aksesorë gjumi, si dhe produkte të tjera të ngjashme.
2. Në kuadër të verifikimit të ankesës të paraqitur nga qytetari R.B., nëpërmjet së cilës pretendon se ka marrë telefonata promovionale pa pëlqimin e tij, rezulton se

Kontrolluesi kryen marketing të drejtpërdrejtë nëpërmjet telefonit. Për kryerjen e këtij marketingu përdor sistemin VICidial, i cili telefonon numra rastësorë të gjeneruar me formula matematikore. Pas telefonatës me klientët, operatori duhet të zgjedhë një prej listave me numra telefoni, për të bërë filtrimin e klientit. Në rast se klienti nuk dëshiron të telefonohet, atëherë operatori e filtron telefonatën në opsionin “Do not call”.

Nga verifikimi i kryer rezulton se, numri i cili ka telefonuar ankuesin përdoret nga Kontrolluesi për qëllim marketingu. Gjithashtu, numri i telefonit të ankuesit, nuk rezulton të jetë vendosur pas telefonatës në listën e “Do not call”.

Kontrolluesi nuk mund të dokumentojë marrjen e pëlqimit nga ankuesi për qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, duke vepruar në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, i cili parashikon se “Mbledhja e të dhënave personale, që lidhen në mënyrë unike me një subjekt të dhënash, për arsye të tregtimit të drejtpërdrejtë, lejohet vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e shprehur qartë”.

Për sa më sipër, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin paraprak dhe të shkruar për përpunimin e të dhënave të tyre për qëllime marketingu, pavarësisht mënyrës së gjenerimit të të dhënave është në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

3. Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “emër”, “mbiemër”, “adresa e klientit”, “numër telefoni”, etj. Këto të dhëna ruhen nga Kontrolluesi, pa një afat konkret për ruajtjen e tyre, në kundërshtim me germën “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

4. Kontrolluesi ka lidhur kontrata me palë të treta, konkretisht:

- Akt Marrëveshje, datë 30.08.2022 me A.E.Distribution SHPK “Për ofrimin e të drejtës së përdorimit të zgjidhjes së certifikuar softuerike A.E.CLOUD”;
- Kontratë Bashkëpunimi, datë 02.11.2020 me Albanian Courier;

Nga verifikimi i kontratave me palët e treta, rezulton se, nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, *Udhëzimi nr. 19*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin, në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojnë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me Përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të Përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Detyrimet e Përpunuesit për përpunim të ligjshëm të të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e parashikimeve të Udhëzimit nr. 19.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për “*Njoftim*” në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Kontrolluesi vendosi në dispozicion të grupit të hetimit administrativ “*Formularin e Njoftimit*” në datën 04.05.2023, pas fillimit të hetimit administrativ.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “*Njoftim*” mbi përpunimin e të dhënave personale, për të cilat Kontrolluesi është përgjegjës, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre, sipas Ligjit.

6. Kontrolluesi disponon “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” por, nga verifikimi rezulton se kjo rregullore është sipas modelit “*tip*”, dhe nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, konfidencialitetin, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 06.06.2023, paraqiti me shkrim pretendimet mbi konstatimet e procesverbalit.

- Lidhur me konstatimin e pikës 3 të procesverbalit Kontrolluesi shprehet “...*Të dhënat e klientëve në faturë janë detyrim ligjor për të përpunuar faturën tatimore... Afati i ruajtjes dhe i përpunimit të këtyre të dhënave është i përcaktuar dhe i detyrueshëm me ligj, pasi këto dokumente janë objekt i kontrollit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, etj., dhe të dhënat ruhen vetëm në afatet e përcaktuara dhe kërkuara me ligj nga institucionet e sipërcituara.*”

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të bëjë vlerësim, për të gjitha proceset e përpunimit në mbështetje të ligjeve apo akteve nënligjore që rregullojnë fushën e veprimtarisë, dhe duhet të marrë masa për përcaktimin dhe rregullimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave për secilën kategori të dhënash të grumbulluara, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, të cilat duhet të jenë të shkruara qartë në rregullore dhe akte të tjera të brendshme të Kontrolluesit.

- Lidhur me konstatimin e pikës 6 të procesverbalit Kontrolluesi shprehet “...*Është një rregullore tip por e përshtatur sipas nevojave të kompanisë tonë. Nenet e vendosura parashikojnë të gjithë mënyrat, mjetet, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, informimin e stafit mbi detyrimet ligjore për mënyrën e përpunimit të të dhënave, qëllimin dhe kushtet e sigurisë që duhet të zbatohen në ato pak procese që bëjnë përpunim të dhënash...*”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, rregullorja e vendosur në dispozicion të grupit të kontrollit, nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori të dhënash) që përpunon, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 39 pika 1, germa “a”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Kontrolluesi duhet të ndalojë menjëherë formën e aplikuar për përpunimin e të dhënave personale për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë;
- 3- Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 4- Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
- 5- Kontrolluesi në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;

- 6-** Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, etj.;
- 7-** Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
- i. menjëherë, detyrimet e përcaktuara në pikën 2 më sipër;
 - ii. vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 3 dhe 5 më sipër;
 - iii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 4 më sipër;
 - iv. brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 6 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

- 8-** Kontrolluesi të njoftojë Zyren e Komisionerit për masat e marra;
- 9-** Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
- 10-** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 14.6.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi